



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

SHESHI “NËNË TEREZA”, REKTORATI I UT-së, TIRANË
TEL. +4 228402, FAX: +4 223981

VENDIM

Nr. 3 datë 19.01.2017

“Për miratimin e strukturës së grupit të punës për hartimin e Statutit dhe Rregullores së Universitetit të Tiranës”

Bazuar në nenin 38 të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 19 të Statutit të UT-ës, si dhe në Vendimin e Rektoratit nr. 2, datë 16.01.2017, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës, në mbledhjen e datës 19.01.2017,

VENDOSI:

- 1.** Miratimin e strukturës së grupit të punës për hartimin e Statutit dhe Rregullores së Universitetit të Tiranës sipas propozimeve të njësive përkatëse, të përbërë nga:
 - Përfaqësues të të gjithë fakulteteve të UT
 - Tre pedagogë ekspertë të Fakultetit të Drejtësisë
 - Një përfaqësues nga studentët e UT
 - Një përfaqësues nga Bordi i Administrimit të UT
- 2.** Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

MNYR KONI